



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2022 PËR PERIUDHËN 12/MUJORE

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neri 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor” është hartuar “Raporti për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022 për periudhën 12/mujore

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr. 68 /2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr. 115/2021 “ Për buxhetin e vitit 2022 ”*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.9 datë 20.03.2018. “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ”*
- *Udhëzimin plotësues te Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.01 dt 10.01.2022 “Përzbativin e buxhetit të vitit 2022 ”.*
- *Ne Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2022 ”*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një ritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për vitin 2022.

### **CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇË**

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qëndrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligji. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qëndrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e kordinimin e politikave midis njësive të qeverisjes vendore të rajonit.

Këshilli i Qarkut Krcë ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim miçis të gjithë partnerëve lokalë e rajonalë për pjesëmarje në projekte gjithëpërfshirëse. Këshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarje në Programet ndërkufitare të financaura nga Bashkimi Europian etj, me synim zhvillimin ekonomiko social të Rajonit dhe ritjen e cilesisë së shërbimeve për komunitetin.

### ***OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2022***

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut për vitin 2022

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qënarore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korce.*
- *Pjesëmarja ne Programet ndërkufitare e me gjere është kriimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin ndërrajonal.*
- *Permiresimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Permiresimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit Europian.*

### ***REALIZIMI I BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR 12/MUJORIN E VITIT 2022***

Zbatimi i Buxhetit të Këshillit të Qarkut për 12/mujorin e vitit 2022 ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat i një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vetë Institucionit si dhe një menaxhim të mirë të shpenzimeve në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe programeve të planifikuara për këtë vit.

#### ***Burimet e financimit :***

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

#### ***Funksionet kryesore të strukturave financiare :***

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

#### **➤ Analiza e realizimit të të ardhurave për periudhën 12/mujore**

Të ardhurat e veta per periudhen 12/mujore janë parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë në konsideratë të dhënat e ecurisë së arkëtimeve të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2021.

### **Llojet e tē ardhurave që ka arkëtuar institucion i gjatë periudhes kanë qënë si më poshtë:**

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut në funksion të shërbimeve që ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2021, të cilat janë planifikuar te perdoren per financimin e shpenzimeve të planifikuarar për këtë vit buxhetor

Gjatë kësaj periudhe Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përmbyshjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh një balancë të drejtë midis burimeve të financimit dhe realizimit të shpenzimeve në përbushje të aktiviteteve dhe programeve të miratuara për vitin 2022.

### **Të ardhurat në buxhetin e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:**

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani 2022 12/mujor	Fakti 2022 12/mujor	Realizim ne %	Diferencia ne leke
1. Transferta e pakushtezuar	58691	58691	100	0
2. Te ardhurat e veta	7030	2227	31.7	4803
a. Te ardhura nga tarifat	1030	327	31.7	703
b. Kontributi financier i bëshkive	6000	1900	31.7	4100
3. Te ardhura te trasheguara 2021	64953	64953	100	0
4. Transferta e kushtezuar	6423	6423	100	0
<b>Totali 2022</b>	<b>137097</b>	<b>132294</b>	<b>96.5</b>	<b>4803</b>

Për vitin 2022, të ardhurat në buxhet janë realizuar në vlerë 132294 mijë lekë ose 96.5% e planit, të ndara sipas natyrës janë:

Transferta e pakushtezuar më vlerë 58691 mijë lekë është realizuar 100%, kjo e ardhur vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe është përdorur për financimin e funksioneve të veta në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Celja e saj është bërë në mbështetje të planit fillestar të buxhetit të ndarë në tremujorë. Gjatë periudhës është bërë një shësë prej 72 mijë lekësh si transfertë e pakushtezuar specifike, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Të ardhurat e vetë institucionit për 12/M e vitit 2022 janë realizuar ne vlerë 2227 mijë leke 31.7 % eplanit, me një diferençë në buxhet 4803 mijë lekë. Theksojmë se këto të ardhura planifikohen mbi bazën e realizimeve të periudhave të mëparshme. Për nga vetë natyra që kanë, nuk mund të parashikohen saktë arkëtimet nga tarifat. Ndërsa realizimi i të ardhurave nga kontributi financier i Bashkive vazhdon të mbetet i ulët pasi Bashkitë nuk i derdhin kontributet e tyre për llogari të Qarkut, edhe pse e kanë detyrim ligjor.

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2021 në total janë në vlerë 64.9 milion lekë (grant + të ardhura), të cilat janë planifikuar të përdoren sipas vendimeve të Këshillit të Qarkut. Këto fonde janë në nivele të larta, janë akumuluar gjatë katër viteve të fundit dhe janë planifikuar të përdoren kryesisht në projekte IPA si për financimet e 15 % të pjesëmarjes në buxhetet e Projekteve të fituara nga Programet IPA CBC 2014-2020 si dhe fonde të menjta që përfunduan përfunduan dy projekte të cilat janë në fazën e kontrollit.

Të ardhurat e realizuara në total janë përdorur për financimin e funksioneve të veta të përcaktuara si më poshtë:

- Pagat e personelit,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.
- Për shpenzime operative
- Investime
- Bashkefinancim Projekte te BE
- Investimene infrastrukturre sipas propozimeve te bashkive dhe miratimit ne Keshillin e Qarkut

### **Të ardhura nga fonde t e kushtëzuara për vitin 2022**

Gjatë periudhës 12/mujore, Këshilli i Qarkut për përbushjen e funksioneve të deleguara, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde nga buxheti i kushtezuar në shumën prej **6423 mijë lekë**. Keto fonde jane përdorur per financimin e aktivitetit te Drejtorisë se Administrimit dhe Mbrojtjes ne Qark e cila eshte funksion i deleguar Gjate kësaj periudhe ka patur një pakësim prej 100 mijë lekës në këtë zë të buxhetit në llogarinë 600. Gjithashtu edhe një shtesë prej 100 mijë lekësh për mbështetjen financiare sipas VKM-së përkatëse që doli ne muajin Dhjetor 2022, në llogarinë 606.

### **Analiza e realizimit të shpenzimeve për vitin 2022**

Shpenzimet e buxhetit gjatë kesaj periudhe janë realizuar në shumën prej **60307.6 mijë lekëngë** **129908.1 mijë leke** te planifikuara ose **46 %**.

Nga totali i shpenzimeve për periudhën 12 mujore, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **36021.6 mijë leke ose 85%** ndaj planit prej **42231.6 mijë lekë** vetëm për programin 01110 të miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut. Mosrealizimi i këtij zërit të shpenzimeve lidhet me mosrealizimin e disa projekteve si dhe me disa vakanca qe ka patur Keshilli i Qarkut gjatë të gjithë vitit 2022. Për sa i përket shpenzimeve per projektet e BE-së, një pjesë e shpenzimeve për projektet IPA janë financuar me fonctet që janë celur nga donatori në bankat e nivelit të dytë, kjo shpjegon edhe arsyen e mosrealizimit të buxhetit për keto programe.

Shpenzimet kapitale për periudhën 12 mujore janë realizuar në vlerë **12157 mijë lekë ose 24%** të planit prej **50922.5 mijë lekë**. Një pjesë e projekteve janë në fazë zbatimi dhe do të financohen gjatë vitit 2023 në vazhdim, ndërsa një pjesë janë në proces prokurimi. Ndërsa për sa i përket projekteve me financim të huaj, një pjesë e tyre janë likujduar me fonde në Bankën e nivelit të dytë.

### **Realizimi i shpenzimeve per 12/mujorin e vitit 2022 paraqiten si me poshtë**

**Ne 000/leke**

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan 12 mujor	Fakt 12mujor	Diferencia	% realizim
<b>1</b>	<b>Administrata – Programi 01110</b>	<b>54351.6</b>	<b>41489.6</b>	<b>12862</b>	<b>76.3</b>
	Paga personeli	14759	12615	2144	85.5
	Sigurime shoqërore e shendetësore	2520	2089	431	83
	Shpenzime operative, keshilltare e vendime gjyqesore	9272	6922	2350	75
	Transferta korente te rendshme	<b>15470</b>	<b>14195</b>	1275	92

	Nga keto:				
	- Bashkia Korce Projekti “Qendra diiore per moshen e trete”	3000	3000	0	100
	- Projekti “vemendje kujdes e sherbime mosha e trete	1000	1000	0	100
	- Qendra rezidentiale e zhvillimit	150	0	150	0
	- Projekte te shkollave te mesme	300	0	300	0
	- Aktiviteti me Bashkine Kol	800	800	0	100
	- Festa e Mokres	100	100	0	100
	- Korca oper air	400	0	400	0
	- Qendra Kujdesit Shendetosor Familjar – Kujdesi Paliativ	400	400	0	100
	- Projekti me Spitalin Rajonal Korce	960	760	200	79
	- Aktivitete bashkive	100	0	100	0
	- Kontributi per Un.Fan Noli	300	180	120	60
	- Projekti per pastrimin e bregut te licenit	7150	7150	0	100
	- Shoqata e te verberve	410	410	0	100
	- Projekti me Shoqaten e Bleteritesve	400	395	5	99
	Transfera tek individet, familjaret	210.6	200.6	10	95
	Investime kapitale	12120	5468	6652	45
<b>2</b>	<b>Drejt.DAMT –Programi 01160</b>	<b>6423</b>	<b>4166</b>	<b>2257</b>	<b>65</b>
	Paga personeli	5200	3371	1829	65
	Sigurime shoqerore e shendetsore	823	563	260	68
	Shpenzime operative	300	132	168	44
	Transfera tek individet, familjaret	100	100	0	100
<b>3</b>	<b>Bashkefinancim ne Projekte me fonde Bashkimit European-Programi 08250</b>	<b>3304</b>	<b>3304</b>	<b>0</b>	<b>100</b>
	Programi 08220	9607	3654	5953	38
<b>4</b>	<b>Projekti IPA – Ëincome – Programi 04220</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Projekti IPA – Ëaste Rreact – Programi 05100</b>	<b>1800</b>	<b>0</b>	<b>1800</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Projekti IPA – Save Ëater- Programi 06330</b>	<b>15420</b>	<b>1005</b>	<b>14415</b>	<b>6.5</b>
<b>7</b>	<b>Projekti IPA – Save Safe Ëater – Programi 06330</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>8</b>	<b>Fondi rezerve</b>	<b>200</b>	<b>0</b>	<b>200</b>	<b>0</b>
<b>9</b>	<b>Projekti arsimi baze e parashkollar-Programi 09120</b>	<b>6192</b>	<b>6146</b>	<b>46</b>	<b>99</b>
	Arsimi i mesem 09230	6708.5	0	6708.5	0
<b>10</b>	<b>Projekt Rrjeti Rrugor rural- Programi 04520</b>	<b>25902</b>	<b>543</b>	<b>25359</b>	<b>2</b>
	<b>Total KESHILLI I QARKUT</b>	<b>129908.1</b>	<b>60307.6</b>	<b>69600.5</b>	<b>46</b>

## **Analiza analitike e shpenzimeve për periudhen 12/mujore, (për Administratën)**

Buxheti i periudhës 12/mujore për vitin 2022 për administratën e Këshillit të Qarkut është realizuar në nivelin **46%** dhe në vlerë absolute **60307.6 mijë leke** nga **129908.1 mijë leke** te programuara. Menaxhimi i buxhetit per kete periudhe është bërë sipas programeve të miratuara në plan, duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke patur një bilanc pozitiv të pagesave brenda limiteve të miratuara nga Keshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **36021.6 mijë leke ose 85%** ndaj planit prej **42231.6 mijë** lekë vetëm për programin 01110 të miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut. Ecuria e shpenzimeve korente për paga, sigurime shoqerore e shpenzime operative ka qënë në përpjestim të drejtë për cdo muaj duke përbushur te gjitha nevojat dhe detyrimet përfunksionimin normal të Administratës. Mosrealizimi është kryesish në shpenzimet për paga, pasi Këshilli i Qarkut për vitin 2022 ka patur disa vakanca. Gjithashtu edhe në shpenzimet operative kemi disa aktivitete të cilat nuk u realizuan sipas parashikimit.
- Shpenzimet kapitale për programin 01110 kane qene te planifikuara ne vlerë **12120 mijë lekë** dhe jane financuar **5468 mijë lekë**. Realizimi i këtyre zëri është **45%**, një pjesë e projekteve është zbatohej ne vitin 2023.

### **a. Shpenzimë për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600–601)**

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën 12 mujore për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata perbehet nga 13 punonjës ( 10+3 ), të cilët paguhen me nivelin e pagave të miratuara në Këshillin e Qarkut. Fondet përfinancimin e këtyre shpenzimeve janë nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2022. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore përkate periudhe eshte ne vleren **14704 mijë leke ose 85%** ndaj **17279 mijë leke** te miratuara sipas programit. Kjo per shkak te levizjes te punonjësve kete periudhe dhe krijimit te vakancave, si dhe për shkak të mospërdorimit të fondit të vecantë.

### **b. Shpenzimet Operative, keshilltarë dhe vendime gjyqesore (Artikulli 602)**

Realizimi i shpenzimeve operative, keshilltarë dhe vendime gjyqesore përkate periudhë është bërë në mbështetje të programeve dhe aktivitetave të miratuara në Këshillin e Qarkut. Niveli i realizimit të ketyre shpenzimeve është **6922 mijë lekë ose 75%** ndaj **9272 mijë lekë** të miratuara. Për 12/mujorin e vitit 2022 janë plotësuar të gjitha nevojat përkaktivitetin e Administratës dhe nuk kemi faktura të pa likujduara. Disa nga aktivitetet dhe shpenzimet që ishin planifikuar, nuk u realizuan si psh blerje pajisje kancelarie, mirembajtje dhe riparim zyre, materiale elektrike apo hidraulike, shpenzime dekorimi, transport grupi folklorik, shpenzime gjyqesore etj.

Nga analiza niveli i shpenzimeve rezulton si me poshtë:

- Shpenzime per energji, uje telefona fix e celulare e shpenzime postare Art. 602.2 janë realizuar ne nivelin **795 mijë leke**.
- Shpenzime per riparim auto Art. 6023 janë realizuar ne nivelin **1721 6 mijë leke**
- Shpenzimet per udhetim e dieta Art. 6024 janë realizuar ne nivelin **1583 mijë leke**

- Shpenzime per pagesa te vendimeve gjyqesore Art. 6027 jane realizuar ne nivelin 170.6mije leke te cilat jane shpenzime per detyrime te trasheguara te parashikuara ne borxhi.
- Shpenzime per pagesen e shperblimit per anetaret e Kryesise te Këshillit te Qarkut Art. 6029 jane realizuar ne nivelin 900 mije leke
- Shpenzime te tjera operative, si aktivitete, honorare, kuota antaresimi dhe tarifa vendore Art. 6029 jane realizuar ne nivelin 1422.5 mije leke

Te gjitha shpenzimet janë bërë sipas programit buxhetor të miratuar rë Këshillin e Qarkut per periudhën vjetore. Likujdimi i detyrimeve është bërë edhe kundrejt amortizimit të tyre të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, si dhe në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”.

c. ***Shpenzimet për Pagesat e Transfertave të Brendshme (Artikulli 604)***

Në këtë artikull përfshihen shpenzimet e planifikuara për transfertat e brendshme siç janë ato të Shoqatave të Verbërvë të Qarkut Korce, kontribut financiar per Qendren e Sherbimit Paliativ Korcë, qëndra rezidenciale e zhvillimit Korcë, pjesëmarje ne Projektin e përbashket me Bashkinë Korcë “Qëndra ditore të moshës së tretë” si dhe në Projektin e Aeronautikës Shqiptare “Korca Open Air”, Projekti me Spitalin Rajonal Korcë, projekti me shqatën e bletërritesve, projekte me shkollat e mesme të rajonit. Për këtë periudhë janë realizuar dhe financuar projekti ‘Qëndra ditore e moshës të tretë’, projekti ‘Vemendje kujdes e shërbime,mosha e tretë’, shoqata e të verbërvë, qendra e kujdesit shëndetesor familjar(kujdesi paliativ), Aktiviteti me Bashkinë Kolonjë, Projekti per pastrimin e bregut të lisenit me Bashkinë Pogradec, Kontributi per Universitetin Fan Noli, Projekti me Spitalin Rajonal, Festa e Mokrës si dhe projekti me shqatën e bletërritesve.

Financimi sipas zerave eshte:

Ne 000 lekë	PLANI	FAKTI
- Bashkia Korce Projekti “Qendra ditore per moshen e tretë”	3000	3000
- Projekti “vemendje kujdes e shërbime mosha e tretë”	1000	1000
- Qendra reziendale e zhvillimit	150	0
- Projekte te shkollave te mesme	300	0
- Aktiviteti me Bashkine Kol	800	800
- Festa e Mokres	100	100
- Korca open air	400	0
- Qendra Kujdesit Shendetosor Familjar – Kujdesi Paliativ	400	400
- Projekti me Spitalin Rajonal Korcë	960	760
- Aktivitete bashkive	100	0
- Kontributi per Un.Fan Noli	300	180
- Projekti per pastrimin e bregut te lisenit	7150	7150
- Shoqata e të verbërvë	410	410
- Projekti me Shoqaten e Bleteritesve	400	395

Projekti me Qëndrën Rezidenciale të zhvillimit, projekti me shkollat e mesme si dhe Korca open air nuk u realizuanpër një sërë problematikash.

#### c. *Shpenzimet Kapitale Investimet (Artikulli 230-231)*

Shpenzimet kapitale për periudhën 12 mujore janë realizuar në vlerë **12157 mijë lekë ose 24%** të planit prej **50922.5 mijë lekë**. Një pjesë e projekteve janë në fazë zbatimi dhe do të financohen gjatë vitit 2023 në vazhdim, ndërsa një pjesë janë në proces prokurimi.

#### **Analiza analitike e shpenzimeve përfunksionet e deleguara (DAMT në qark )**

Këshilli i qarkut në përbushje të funksioneve të deleguara si funksioni i Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes të Tokës në qark, ka të programuar në Buxhetin e tij edhe fonde nga transfera e kushtëzuar, të cilat delegohen nga Buxheti i Shtetit.

Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet e përgjithshme përfunksionimin e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën 4166 mijë lekë nga €423 mijë lekë te planifikuara. Shpenzimet e bëra përf këtë funksion janë financuar 100 %. Në këtë mosrealizim ka ndikuar mungesa e dy punonjësve përf këtë periudhë.

#### *Shpenzime përf Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)*

Shpenzimeve përf paga dhe sigurime shoqërore përf periudhën 12/mujore të vitit 2022 përf punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës si dhe nivelit te pagave te miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave.

Përf kete periudhë numri i punonjësve përf këtë drejtori ka qenë 5 punonjës nga 7 të planifikuar. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore është në vlerën **3934 mijë lekë**, kundrejt fondit të programuar në vlerë **6023 mijë lekë ose e shprehur në përqindje në 65%**. Kjo lidhet me mungesën e dy punonjësve përf këtë periudhë dhe mos përdorimit të fondit të vecantë. Gjithashtu në këtë zë ka një planifikim me një rezervë të vogël.

#### *Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)*

Përf periudhën vlera e shpenzimeve operative është planifikuar 300 mijë lekë dhe realizimi i tyre eshte ne nivelin 132 mijë lekë, kjo lidhet me situatat e krijuara dhe mos realizimin e prokurimeve të planifikuar përf këtë drejtori. Përf këtë periudhë janë financuar vetëm shpenzime përf energji elektrike dhe ujë në vlerë 62.8mijë lekë, shpenzime postare në vlerë 45 mijë lekë, shpenzime telefonie 24 mijë lekë.

#### **Realizimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut përf pjesëmarje në Programe ndërkombëtare**

Përf periudhën 12/mujori 2022 në Programin buxhetor të Keshillit te Qarkut eshte planifikuar buxhet per financimin e projekteve me fonde nga Bashkimi Europian. Keshilli i Qarkut në zbatim të funksioneve të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore ka marë pjesë gjëresisht rë aplikimet përf projekte sipas Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC si dhe në Programe të tjera ndërkufitare. Aktualisht janë në proces zbatimi 3 projekte me një vlerë totale prej rreth 1061mijë euro si më poshtë:

- Save – Eater me vlerë 802594.00 euro
- Easte Rreact me vlerë 93967.59 euro
- CLLD Cul Tour 164350.00 euro

Për këto projekte janë nënshkruar kontratat me partneret dhe ka filluar implementimi i tyre që në vitin 2018. Financimi i shpenzimeve për keto projekte ka filluar në vitin 2019 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022 sipas afateve të parashikuar në kontratat përkatëse. Për këtë qëllim në Buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2022 janë planifikuar 33871 mijë lekë ( grant + te ardhura ) me gjithe ndryshimet perkatese. Realizimi i tyre për 12/mujorin është në nivelin 7963 mijë lekë. Theksojmë se projektet pjesërisht janë financuar me fonde të vetë institucionit, një pjesë e shpenzimeve janë financuar nga fondet e celura nga donatore në bankat e nivelit të dytë, për këtë arsyes dhe % e realizimit të tyre është e ulët. Ecuria e realizimit dhe financimit të projekteve është bërë kundrejt kontratave të nënshkruara dhe afateve të percaktuara në to. Në fund të vitit 2021 kanë përfunduar dy projekte Ëincome dhe Save Safe Eater, te cilat janë në fazën e konfirmimit përfundimtar. Gjithashtu në zbatim të Udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, për llogari të buxhetit për projektet janë planifikuar edhe 40 milion lekë ne kapitullin 2 si limit per realizimin e disbursimit të fondeve të projekteve nga bankat e nivelit të dytë në llogari të Këshillit të Qarkut pranë Degës së thesarit, kjo në momentin e përfundimit të projekteve.

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI



KESHILLI I QARKUT KORCE

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Per periudhen 12/mujori 2022

ne 000/leke

Emri i Grupit	Këshilli i Qarkut Korce					Kodi i Grupit	2015001	
Programet		Shpenzimet e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore						
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i viti paraardhes Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes progresive 12/ mujori 2022	(6) Fakti i Periudhes progresive 12/mujori 2022	(7)=(6)-(5) Diferenca
01110	Administrata e Keshillit te Qarkut	22,419.4	50,406.0	46,671.0	56,641.6	54,351.6	41,489.6	12,862.0
01160	Drejtoria e AMT ne qark	4,614.0	6,423.0	6,423.0	6,423.0	6,423.0	4,166.0	2,257.0
08250	Bashkefinancim ne Programe te BE	4,457.0	17,150.0	17,150.0	7,044.0	3,304.0	3,304.0	0.0
04220	Projekte IPA- Wincome	3,762.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
05100	Projekte IPA- Waste React	0.0	0.0	1,800.0	1,800.0	1,800.0	0.0	1,800.0
06330	Projekte IPA- Save Water	4,296.0	15,420.0	15,420.0	15,420.0	15,420.0	1,005.0	14,415.0
06330	Projekte IPA- Save Safe Water	1,438.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
04980	Fondi Rezerve	0.0	1,500.0	1,500.0	1,200.0	200.0	0.0	200.0
09120	Projekt arsimi baze e parashkollar	3,140.0	13,880.0	6,191.5	6,191.5	6,192.0	6,146.0	46.0
08220	Projekti CLLD Cultour	0.0	0.0	0.0	9,607.0	9,607.0	3,654.0	5,953.0
09230	Arsimi i mesem	0.0	0.0	0.0	6,708.5	6,708.5	0.0	6,708.5
04520	Projekt Rrjeti Rrugor Rural	19,332.0	13,900.0	25,037.6	25,902.0	25,902.0	543.0	25,359.0
.....	.....							
<b>Totali i Shpenzimeve të Njësisë</b>		<b>63,458.4</b>	<b>118,679.0</b>	<b>120,193.1</b>	<b>136,937.6</b>	<b>129,908.1</b>	<b>60,307.6</b>	<b>69,600.5</b>
<b>Totali</b>		<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>

Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Ana VERUSHI
	Firma	
	Data	

KESHILLI I QARKUT KORCE

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Per periudhen 12/mujori 2022

ne 000/leke

Këshilli Qarkut	KORCE						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2015001
Programi	01110						Kodi i Programit	01110
Art.	Emërtimi	-1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	-2 PBA Plan 2022	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillesatar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv 12/mujor 2022	-6 Fakti Periudhes/progresiv 12/ mujor 2022	(7)=(6)-(5) Diferencia
600	Paga	13138	15670	15770	15059	14759	12615	2144
601	Sigurime Shoqërore	2167	2547	2520	2520	2520	2089	431
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3935	10559	10200	10272	9272	6922	2350
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	2420	8010	8010	16460	15470	14195	1275
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	123.5	0	0	210.6	210.6	200.6	10
<i>Nen-Totali</i>	<i>Shpenzime Korrente</i>	<i>21783.5</i>	<i>36786</i>	<i>36500</i>	<i>44521.6</i>	<i>42231.6</i>	<i>36021.6</i>	<i>6210</i>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	635.9	13620	10171	12120	12120	5468	6652
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
<i>Nen -Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</i>	<i>635.9</i>	<i>13620</i>	<i>10171</i>	<i>12120</i>	<i>12120</i>	<i>5468</i>	<i>6652</i>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
<i>Nen -Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>	<i>635.9</i>	<i>13620</i>	<i>10171</i>	<i>12120</i>	<i>12120</i>	<i>5468</i>	<i>6652</i>
<i>Totali (korrente + kapitale )</i>		<i>22419.4</i>	<i>50406</i>	<i>46671</i>	<i>56641.6</i>	<i>54351.6</i>	<i>41489.6</i>	<i>12862</i>
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues tē Programit	Oljona Beqiraj	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri	Ana	VERUSHI		
Firma				Firma				
Data	25/01/2023			Data				

KESHILLI I QARKUT KORCE

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

Per periudhen 12/mujori 2022

ne 000/leke

Këshilli Qarkut	KORCE						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2015001
Programi	01160						Kodi i Programit	01160
Art.	Emertimi	-1 Fakti i viti paraardhës Viti 2021	-2 PBA Plan 2022	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillesatar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv 12/ mujor 2022	-6 Fakti Periudhes/progresiv 12/ mujor 2022	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	3680	5300	5300	5200	5200	3371	1829
601	Sigurime Shoqërore	614	823	823	823	823	563	260
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	261	300	300	300	300	132	168
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transfera Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transfera Korente te Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	59	0	0	100	100	100	0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	4614	6423	6423	6423	6423	4166	2257
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Transfera Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transfera Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
	Totali (korrente + kapitale )	4614	6423	6423	6423	6423	4166	2257
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri Olimpia Beqiraj	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Ana				
	Firma		Firma					
	Data 25/01/23		Data					



KESHILLI I QARKUT KORCE

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve  
Per periudhen 12/mujori 2022

ne 000/leke

Këshilli Qarkut	KORCE							Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2015001
Programi	08260							Kodi i Programit	08250
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	-2 PBA Plan 2022	-3 Buxhoti Vjetor Plan Fillesatar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv 12/ mujor 2022	-6 Fakti Periudhes/progresiv 12/ mujor 2022	(7)=(6)-(5) Diferencia	
600	Paga	0	0	0	0	0	0	0	
801	Sigurinje Shqërore	0	0	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tiera	4457	5000	17150	7044	3304	3304	0	
